

PIRO MILKANI
E PABESUESHME, POR E VËRTETË

BOTIMET TOENA

PIRO MILKANI

E PABESUESHME, POR E VËRTETË

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2018

Ky libër u mundësua falë mbështetjes së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Forumit të Mbrojtjes të Autorëve të Audiovizualit.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-25-1

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

PËRMBAJTJA

E pabesueshme, por e vërtetë.....	13
Profesor Hrdlička dhe një vdekje e papritur.....	14
Dora e parë e Zotit.....	17
Sauna finlandeze.....	26
Dasma e Viktorit, Ema Çerna dhe Butrinti.....	33
Një vizitë plot emocione.....	50
Si e martova Shankarin.....	53
Një gënjeshtër e bardhë.....	61
Helena dhe Milena Adler.....	71
Përse bie kjo daulle.....	78
Klienti normal.....	98
Mikelanxhelo Antonini dhe Klaudio Gubitosi.....	102
Marshali Radecki dhe Heronjtë e Vigut.....	108
Bekim Fehmiu, ky Marlon Brando shqiptar.....	149
Marko Polo.....	168
Filmografi.....	171
Falënderim.....	175

GJITHË AJO JETË E MADHE

Për një artist të shumënjohur e të dashur për publikun shqiptar, si Piro Milkani, Artist i Popullit, një nga pionierët themelues të kinematografisë shqiptare, do të ishte e pakuptueshme të mos linte pas kujtimet e një jete. Mund të quhej pa frikë një humbje për filmografinë tonë, boshllëk në historinë e filmit shqiptar, sepse fati e ka përkëdhelur të jetë bash në qendër të gjithë atyre ngjarjeve të mëdha të këtij arti kaq të dashur prej themelimit e deri në ditët tona. Shkurt, në shprehjet e bisedave ligjërimore të gjuhës së përditshme, për këto raste thuhet shkurt: gjynah të mos shkruhet gjithë ajo jetë e madhe.

E Milkani e ka pasur këtë fat me shumicë, me shkollimin e tij në një nga shkollat më brilante e me emër të ndritur të kohës së tij, me shokë që vinin nga gjithë anët e globit e bënë emrin e tyre të madh nga Amerika deri në Indinë e largët. Pastaj, përkëdheljen, të ishte një nga kamerat e para të filmit shqiptar, i cili

sapo ngrihej si motak në këmbë, si regjisor, që fati u tha: “Ju jeni të parët e me të drejtën e shenjtë të të parit do të hidhni themelet. Më vonë historia nuk mund të shkruhet pa kaluar nëpër emrat tuaj”.

Dhe ja, tani që po mbush të tetëdhjetat, ka moshën e artë të kujtimeve. Por ndryshe nga shumë të tjerë (një inflacion i padurueshëm librash me kujtime po bën “vapë” mbytëse gjithandej), Piro Milkani, ky i përkëdhelur pafundësisht prej jetës dhe fatit, nuk mund të mos ishte i tillë edhe në këtë fushë, në artin e të shkruarit, ku fati është treguar bujar sërish me talentin e tij të të treguarit shkurt dhe plot emocione.

Nëse duhen pak dëshmi për talentin e tij, me Piron puna bëhet e lehtë ta besosh “a priori” se edhe ky libër kujtimesh lexohet me një frymë falë prirjes së tij të lindur të rrëfimit të këndshëm, aftësisë për t’i marrë gjuhës së mrekullueshme shqipe vezullimet e saj të ligjërimin, lakonizmin dhe shijen e një gjuhe të gjallë vetanake.

E ka dëshmuar këtë Milkani me shqipërimin e një romani të mrekullueshëm, siç është “I kam shërbyer mbretit të Anglisë”, i Bohumil Hrabalit, që e kam lexuar ndër të parët, po edhe me një libër tjetër të rrallë, siç është ai i regjisorit të madh çek “Nga Casllavi në Hollivud” të Milosh Formanit, për të mos përmendur më tej përkthime të tjera, si drama “Opera e Leckamanëve” të Vaclav Havelit (me porosi të Teatrit shqiptar të Shkupit), me “Faedrën” e Rasinit etj.

Në këtë libër, që vjen në 80-vjetorin e tij për lexuesin shqiptar, parakalon një pjesë e vogël, shumë e vogël ngjarjesh nga gjithë ajo jetë e madhe, duke përzgjedhur me një kujdes “shumë koprac” ca ngjarje të bukura që lexohen me një frymë e të tronditin me bukurinë e tyre të rrallë, me gjetjet e tyre poetike që i ka servirur vetë jeta me koincidenat e saj të befta e të pabesueshme, me tekat e fatit, rinjohjet e befta pas dekadash të tëra terri e izolimi me miq të rinisë, takime me artistë të mëdhenj botërorë, fama e të cilëve të mek mendjen e frymën sapo u lexon emrin.

Nëse jeta e tij e gjatë prej artisti (ashtu si jeta e çdo njeriu) është një lumë, Milkani, ulur në breg të tij, ka marrë shoshën dhe ka shpëlarë gjithë rërën e bregut për të gjetur ca thërrime ari, njësoj si ata kërkuesit e dikurshëm në Alaskë, që përshkruan Xhek London. Këtë radhë nuk është ai regjisori e as skenari. Përkundrazi, e tillë është jeta e tij dhe Milkani veç sa ka xhiruar ato episode që i ka diktuar ajo, kujtesa e një jete. Veçse në vend të kamerës, operatori i dikurshëm (që ca gra në Korçë, kur po nisej për në Pragë, i thanë njëra-tjetrës të prisnin edhe ca, sa të kthehej e t'i operonte djali i tyre, që po bëhej doktor-kirurg) në vend të “Arriflex”-it të dikurshëm, sot ka një laps të gjatë kujtese që ka qëlluar i artë.

Nuk do të doja të zbuloja e të digjja kureshtjen e asnjë lexuesi duke analizuar qoftë edhe një tregim të vetëm të përzgjedhur nga kujtesa e tij, por dua të them

se, tek-tuk, në rrëfimet e tij ka diçka që të bind, se legjendat ku ndodhin mrekullitë nuk janë vetëm fryt fantazie e tashmë të vdekura. Jetojnë akoma. Ja një shembull me tregimin “Dasma e Viktorit, Ema Çerna dhe Butrinti”.

Një vajzë e bukur çeke, që shkollohet me të e fle një kat më lart në konviktin e tij dhe me të cilën ka pasur dikur një flirt të bukur dashurie, tashmë ka humbur prej dyzet vjetësh në ndarjen e madhe të ideologjisë së dy shteteve. Një telefonatë pas rënies së komunizmit drejt shoqes së tij bukuroshe nuk i kujton asgjë Emës në Pragë. Ajo e ka harruar emrin e djaloshit korçar me të cilin ka shkëmbyer ca puthje të zjarrta dikur. Por ironia e fatit dhe kripa e rrëfimit nuk mbaron këtu, vazhdon të tallet si në legjenda edhe më tej. Pas 20 vjetësh të tjerë (domethënë plot pas 60 vjetësh), një natë, në Festivalin e Butrintit, pas shfaqjes, Piro dhe Bebi, gruaja e tij, marrin me dëshirë dy aktore çeke në makinë. Rrugës flet me çekishten e tij të shkëlqyer me të renë dhe me gruan e moshuar gjithfarë bisedash zbavitëse. Pastaj ndahen në hotel.

Të nesërmen kap një fletë katalogu dhe risheh emrat e aktorëve të trupës çeke.

Mosss!

Gruaja që solli prej Butrintit në Sarandë dhe u shkrinë së qeshuri gjithë rrugës paska qenë vetë Ema Çerna, vajza e ëmbël me të cilën puthej gjashtë dekada më parë...

Rrëfimet e tjera janë plot e përplot me rastësi të tilla, që bëjnë gjëmime fatesh në kujtesën e lexuesit që do ta ketë në duar.

Duke qenë një mik, nxënës e koleg prej gati i një jete me Piron, një adhurues i rrëfimeve të tij plot jetë e gjallëri, mund të paragjykohe se po e gjykoj me pak hatër këtë libër. Ndaj e solla këtë “çikërrimë” të vogël kaq të bukur prej librit si një dëshmi se të tjera tregime të mrekullueshme ju presin në faqet e tij.

Libra të tillë, që vijnë prej dëshmitarësh të mëdhenj të artit, artistëve themelues të degëve të reja të tij në Shqipëri, siç është filmi, nuk janë më libra kujtimesh personale. E kapërcejnë këtë gjini letrare shumëfish, sepse rrezatojnë më gjerë dhe janë vetë muret mbajtëse të historisë së gjallë të filmografisë shqiptare.

Dhe, së fundi (pse të mos e them?) jam i lumtur e ndihem krenar që ma besoi mua si “mbles” takimin e tij të parë të këtij libri me lexuesin. Sepse kam privilegjin e kaq dëshirueshëm ta uroj i pari duke i thënë:

Faleminderit që po lë pas kaq shumë pasuri,
Mjeshtër!

Petrit Ruka

Tiranë, tetor 2018

E PABESUESHME, POR E VËRTETË

Më ka ndodhur shpesh që shokët e mi, pasi dëgjojnë histori të jetës sime, të më thonë: “Pse nuk i shkruan këto histori?”.

E kanë fjalën për të bërë një libër autobiografik.

Mirëpo, sa më shumë kalojnë vitet, aq më dyshues bëhem vetë për këtë. Kur kujtoj librin me kujtime “Nga Casllavi në Hollivud” të Milosh Formanit, them se është e pamundur t’ua kaloj atyre në mjeshtërinë e të rrëfyerit. Pastaj thënia se “kujtimet shkruhen kur fillon e të lë kujtesa”, më çarmatos fare.

Po pastaj më jep zemër Gabriel Garcia Markezi kur thotë se “jeta nuk është ajo që ke jetuar, është ajo që të kujtohet dhe ashtu siç të kujtohet për ta rrëfyer”.

Ndaj vendosa të rrëfej diçka edhe unë, ndryshe nga Formani. Të tregoj histori të ndryshme që në dukje janë të pabesueshme, por në fakt janë të vërteta.

Kam vendosur që të mos kenë rend kronologjik. Dhe, për t’ju shtuar kureshtjen, po e filloj me tregimin e parë.

PROFESOR HRDLIČKA
DHE NJË VDEKJE E PAPRITUR

Kur mendoj për jetën time, e pranoj se fati më ka ndihmuar shumë. Pata privilegjin të studioj në një fakultet magjik, që as në ëndërr nuk është më i mirë. Të studiosh për kinematografi, në një qytet në zemër të Europës, që shumëkush e etiketon si qytet i artë, duhet të kesh lindur me këmishë. Besoj se e kuptoni që e kam fjalën për... Pragën e Artë, kryeqytetin e Çekosllovakisë së dikurshme (se sot është vetëm Çeki).

Vërtet në një vit shkollor bënim më shumë se 20 lëndë të ndryshme, po ku kishin të krahasuar ato me anatominë e studentëve të mjekësisë, me optikën gjeometrike të studentëve të inxhinierisë apo me formulat e komplikuar të atyre që studionin gjeologji. Ne duhet të mësonim histori arti, histori të kinemasë çeke e botërore, të dinim diçka për librin “Poetika” të Aristotelit e, mbi të gjitha, të shikonim shumë filma, mundësisht tre deri në katër në ditë.

Por, duke qenë se unë studioja në degën e kamerës, kishim dhe një lëndë të çuditshme. Atë që mësonin edhe studentët e inxhinierisë: optikën fizike dhe gjeometrike.

I njëjti profesor që jepte mësim tek inxhinieria, vinte dhe te ne. Ai ishte profesor Hrdliçka, hijerëndë e pedant. I thatë në trup e në fytyrë. Një njeri që nuk i qeshte buza kurrë dhe, për më tepër, kishte një kollë të thatë e kronike, si të atyre që pinë pa pushim duhan. Dhe ai vërtet që e pinte. Për këtë lëndë nuk kishte libër, por vetëm një dispensë të shaptilografuar, autor i të cilës ishte ai vetë: profesor Hrdliçka.

Po t'i jepja kuptim në shqip mbiemrit të tij, do të vinit buzën në gaz. Ai, pra, për mua ishte profesor Kumria. Jo Kumri a Papagall, por as Sorkadhe apo Fajkua nuk ishte. Më shumë se çdo gjëje ai i ngjante një luani të plakur, që nuk e gëzonte më asgjë.

Bënim mësim dy orë në javë me profesorin dhe rrallë bënte vaki të mungonim. Ishte lënda dhe ora më e mërzitshme. Po muajt kaluan me shpejtësi dhe erdhi sezoni i provimeve.

- Të enjten tjetër, në orën 10:00, po në këtë sallë, do të përgatiteni për provimin e vitit, - na tha profesori në mbarim të leksionit.

E morëm lehtas këtë njoftim dhe u përgatitëm shkel e shko. Habia erdhi në fund të provimit kur vetë profesor Hrdliçka na njoftoi se asnjë nga ne nuk e kishte kaluar provimin. Klasa kishte dhjetë studentë çekë dhe dy shqiptarë.

- Të enjten tjetër përsëri në provim, - na tha profesori.

I hymë më me themel të mësuarit të lëndës, por formulat dhe skicat e lenteve optike ishin për ne më të ngatërruara se hieroglifët kinezë.

Ndodhi ajo që pritej. Përsëri asnjëri prej nesh nuk e kaloi provimin dhe të nesërmen profesori Boucek, dekan i fakultetit dhe koleg i Hrdliçkës, gati me dhimbje na komunikoi vendimin e zotit Hrdliçka: “Kush nuk kalon të enjten e ardhshme, do të përsërisë vitin shkollor”. Çekët, edhe mund ta bënin këtë, por për mua dhe Saimin do të thoshte mirupafshim fakultet e Pragë. E dinim rregullin e pashkruar të ambasadës: “Kush ngel në klasë, bën mirë të paketojë plaçkat e të nisët për Shqipëri”.

Ato ditë nuk kam për t’i harruar kurrë. Studim nga mëngjesi në darkë. Kafe në mesnatë që të rrinin zgjuar dhe provat e para për të tymosur ndonjë cigare. Shkurt, torturë e vërtetë.

Askujt nuk i shkonte në mendje se dita e martë, e njohur për shumë popuj si ditë e tersit, do të na jepte kaq shumë “gëzim”. Atë pasdite na njoftuan se profesor Hrdliçka kishte ndërruar jetë. O Zot çfarë turpi! Po gëzoheshim për vdekjen e tij.

Të enjten, në vend të provimit shkuam në varrimin e profesorit. Me zor luanim rolin e të pikëlluarit.

Pas dy javësh na mori në provim asistentja e profesorit. Kuptohet se të gjithë e kaluam provimin me rezultate të larta. Do qëndroja në Pragë edhe disa vite të tjera.

Ishte qershor i vitit 1956.

DORA E PARË E ZOTIT

Shtatori i vitit 1954 ishte fillimi i vitit tim të maturës në gjimnazin “Raqi Qirinxhi” (në godinën e ish-Liceut francez të Korçës), i hapur në mesin e Luftës së Parë Botërore plot 101 vjet më parë, në vitin 1917, nën mbrojtjen e Grande Armée-së franceze që kishte okupuar për dy-tre vjet zonën e juglindjes së Shqipërisë, deri në Selanik të Greqisë.

Në ditët e para të shkollës erdhi për vizitë ministri i ri Arsimit, 30-vjeçari Ramiz Alia.

Ministri Alia zgjodhi, atë mëngjes, klasën tonë, të katërtën A, për të bërë një bisedë të shpenguar me 26 maurantët e klasës sonë. Ndër të tjera na porositi të mësonim fort se vitin që vinte do të kishte më shumë bursa studimi për jashtë shtetit. Po atë ditë na ftoi për një ndeshje volejbolli. Në ekipin e tij ishin drejtuesit e organizatës së rinisë të qytetit me në krye Pandi Allabashin, në anën tjetër

të rrjetës, ne maturantët e të katrës A. Ishin më të fortë e na mundën që në të dyja setet e para.

Për mua, atë vit, ngjarjet më të rëndësishme ishin letrat shumëfaqëshe që Viktor Gjika, shoku im i fëmijërisë, më dërgonte nga Moska. Më tregonte në to jetën e magjishme që po kalonte në Institutin e Lartë të Kinematografisë - VGIK - ku po studionte fillimisht për regjisor filmash dokumentarë shkencorë-popullorë e më pas se si kaloi në katedrën e degës së kamerës (drejtor fotografie). Letra mbyllej gjithmonë me frazën: “Ke të fala edhe nga Taqoja” (e kishte fjalën për djaloshin vlonjat Dhimitër Anagnosti).

Deri në mars të vitit 1955 ato letra ma kishin bërë mendjen çorap, kur drejtori i gjimnazit, Dhori Belba, më thirri në zyrën e tij për të plotësuar formularin e famshëm. Pas pyetjeve rutinë, emri, mbiemri, atësia, profesioni i babait, datëlindja etj., erdhi paragrafi më i rëndësishëm:

- Për çfarë dëshiron të studiosh në shkollën e lartë?

- Inxhinier për përpunimin e lëkurës, - i thashë.

E kishim në Korçë një fabrikë të tillë, që përhapte gjithandej një erë të ndyrë, po sidoqoftë unë do mund të isha inxhinier i saj.

- Tjetër? Pyeti pa e ngritur kokën

- Inxhinier hidroelektrik!

Po ngrihej një hidrocentral mbi lumin Mat, por flitej gjithashtu se do ngriheshin dhe të tjerë.

- Po tjetër?

Pra, bëhej fjalë për tri dëshira. Si në përrallat me mbret. Thuaj tri dëshira dhe unë do t'i plotësoj, i thoshte mbreti fukarait që i shpëtoi jetën vajzës së tij... Heshtje... Ta them, mos ta them? Po sikur të zemërohet? Të dalë ku të dalë. Po e them:

- K i n e m a t o g r a f i !!!

Engriti kokën dhe më pa me sy zhbirues e buzëqeshi paksa me ironi (sigurisht me zë të brendshëm do të ketë shqiptuar: “Spurdhjak... U bëre dhe ti!”).

Po deshi s'deshi e shkroi në formular. E pashë tek shkruante deri te rrokjet e fundit... g r a f i.

- Lajmëro tjetrin, - më tha gjysmë i zemëruar.

Nuk kaloi shumë dhe filloi sezoni i provimeve të maturës. Me përjashtim të Gjergji Angonit, të cilit ia kishin pushkatuar babanë në vitin 1945, apo të Rexhep Bregut, nxënësit më të mirë të klasës sonë gjatë katër viteve të gjimnazit, për shkak se në fshat familjen e tij e kishin shpallur si familje kulakësh, apo të Jani Avramit, që ishte anëtar i partisë së komunistëve, por e kishte babanë emigrant ekonomik, të ikur në Amerikë para luftës, të tjerët mësonin dhe ëndërronin për një bursë jashtë shtetit. Diskutimet bëheshin a ishte më mirë të shkoje në Bashkimin Sovjetik apo në Çekosllovakia se vendin e fundit në preferencë e zinte Bullgaria. A nuk e tha vetë Ramiz Alia se këtë vit do të ketë shumë bursa studimi?

Provimi i parë, matematika me shkrim. Kush e mbaronte detyrën dorëzonte fletën dhe dilte jashtë

klasës. Pandi Pepivani dhe unë e dorëzuam fletën të parët. Jashtë verifikuam rezultatet e ekuacioneve dhe kur ato na u puqën, u bindëm se kishim bërë zgjidhjen e duhur për një notë maksimale. Po ishte ora dhjetë e mëngjesit. Ç'të bënin tani? Të shkonim në shtëpi? Vendosëm t'i ngjiteshim malit të Moravës deri në majë. Të rinj ishim dhe nuk dinim se ku t'i harxhonim energjitë. Po t'i shpejtonim hapat gjatë të përpjetave, e shumta një orë e gjysmë, po ja dhe dy orë e do të mbërrinim në majë të "Everestit" të qytetit tonë. Dhe ashtu u bë. E ç'lodhje mund të kishim? Provimi shkoi në rregull e unë nuk i kisha as shtatëmbëdhjetë vjet. Pandi disa muaj më i madh.

Duke u thekur në diellin që nuk të digjte, si aty poshtë në Korçë, hodha sytë te një gur i rrumbullakët pak më i madh se një top pingpongu. Poshtë tij ishin fshehur dy zhuzhakë të vegjël, që drita e diellit ua bënte më të fortë ngjyrën e tyre jeshile të errët. I mora dhe i mbështolla me një copë letre që m'u ndodh në xhep. Kur u ktheva në shtëpi, e nxora letrën dhe doja t'ia jepja vëllait tim të vogël, Vaskës. Për çudi gjeta vetëm një zhuzhak. I dyti nuk gjendej. "Do jetë arratisur", i thashë Vaskës.

Të nesërmen shkova në bibliotekën e qytetit që të përgatitesha për provimin e matematikës me gojë. Qëndrova aq gjatë, derisa rrezet e diellit më erdhën nga pas shpinës. Qetësi e admirueshme, e përshtatshme për përqendrim maksimal. Befas, një cërr-cërr e fortë theu heshtjen. Të pranishmit ngritën kokat. Ç'është

kjo? As unë s'e kuptova se nga vinte. Po çërr-çërri i dytë ishte dhe më i fortë. Vinte nga poshtë vatave të xhaketës sime. Nxehtësia e rrezeve të diellit e kishte zgjuar nga përgjumja zhuzhakun tim. E godita supin tim të majtë dhe zhuzhaku pushoi. Futa dorën në xhepin e majtë dhe zbulova një shqepje të vogël të astarit. Ja ç'na paska qenë. Ishte arratisur nga brima e astarit. Ndërpreva studimin dhe u largova nga salla.

Provimet i mbarova të gjitha me notat maksimale. Njëlloj si Viktori, një vit më parë, që rrëmbeu një medalje ari. Sa medalje të tjera do të merrte një gjysmë shekulli punë në Kinostudio, Viktori. Po ajo gjithmonë do të ishte e para.

Nuk mbaj mend sesi e mora vesh se më kishte dalë bursa e studimit për jashtë, po gëzimi ishte i pamasë. Pas disa ditësh do të niseshim të gjithë në Tiranë për një seminar. Nga 52 maturantët, më shumë se 20 prej nesh na kishte buzëqeshur fati. Do të studionim jashtë shtetit. Ishte e dyta herë që shkoja në Tiranë, që në krahasim me Korçën më dukej si një metropol i vërtetë. Lektorë të ndryshëm na sqaronin për situatën politike, se si duhet të silleshim që të mos turpëronim Shqipërinë etj., etj., por asnjë fjalë se ku dhe çfarë do të studionim.

- Kthehuni dhe pas disa ditësh merrni në telefon Ministrinë e Arsimit, - na lajmëruan.

Ishin ditët më të gjata të pritjes. Gëzim dhe "ankth". Pas pesë ditësh, u bëmë katër a pesë dhe shkuaam në postën e qytetit. Askush nga ne, veç

disa funksionarëve të zyrave të shtetit e Partisë, të policisë, ushtrisë apo disa mjekëve të qytetit, nuk kishte telefon në shtëpi. Në kabinë hyri Qirjakoja, kur centralistja e lidhi me zyrën e sekretarit të ministrit. Po, po, e kishin vendosur se ku do të shkonim. Pyeti, së pari, për veten e tij. Inxhinier transporti në Çekosllovakia. Pastaj me radhë: Servet Pëllumbi në Moskë për filozofi, Zhaneta Kotmilo dhe Agron Kallamata (i vetmi egjiptian në maturën tonë) në Hungari. Zhaneta për farmaci, Agroni për mjekësi, Asim Ylli në Gjermaninë Lindore, për mjekësi, Servet Backa, në shkollën e sigurimit në Moskë. Pyeti dhe për mua. Në Çekosllovakia, për operator filmi!

O Zot! Ç'më bëre kështu? Ma plotësove dëshirën time. Atë të tretën. Për atë që drejtori më buzëqeshi me ironi kur i thashë se dua të mësoj për kinematografi. Njëlloj si Viktori. Veçse ai në Moskë e unë në Pragë. Nuk qëndrova dot për të marrë vesh se ku do të shkonin të tjerët. Po nxitoja si i marrë drejt shtëpisë për t'u dhënë lajmin prindërve dhe vëllezërve të mi. Po ishte e pamundur. Nxitimim ma ndërpre, tamam para monumentit të Luftëtarit Kombëtar (apo Ushtarit të Panjohur, si e thërrisnim ne) dy mësueset e mia, Dhimitra Gjini apo Maliqarka, mësuese e letërsisë, dhe Arsinoi Bino.

- Hë, mo Piro, për ku të doli bursa? - pyeti plot kureshtje Maliqarka (nuk ka njeri në Korçë që mos ta ketë një nofkë).

- Për Çekosllovakia! Do studioj për operator.

- Uaaa!!! Sa mirë! Dëgjo këtu Arsinoi. Mos e bëj apendicitin pa u kthyer Pirua. Dhe vazhduan rrugën. Nuk kisha kohë t'i sqaroja për gabimin e tyre. Më duhej të shkoja në shtëpi. Asokohe, në Korçë, operator quheshin mjekët kirurgë. U largova pa i sqaruar si duhet. Sigurisht, më vonë e morën vesh "gabimin".

Pas disa ditësh, përsëri në Tiranë. Mbledhjet e fundit para nisjes. Po si ndodhi në të vërtetë kjo mrekulli e Zotit?

Në pranverën e vitit 1955, Ministrisë së Arsimit i kishte ardhur një përgjigje pozitive nga Çekosllovakia, për kërkesën që kishin bërë për dy bursa studimi për operator filmi. Ministria kishte njoftuar Kinostudion. Viktor Stratoberdha, ishte ylli në shkëlqim i regjisorit që u diplomua në Moskë si asistent i profesorit të tij Sergej Jutkeviç, me filmin "Skënderbeu". Kush më mirë se ai do të vendoste për këtë ofertë. Shkoi direkt e në Liceun Artistik të Tiranës dhe u takua me maturantët e degës së Arteve Figurative. Piktoret e skulptorët e ardhshëm. Më mirë se ata me prirje figurative askush nuk mund ta bënte këtë profesion. I pyeti direkt:

- Kush nga ju ka dëshirë të studiojë në Çekosllovakia për operator filmi?

I pari që ngriti dorën ishte Saim Kokona. Po diplomohet për piktor. Ja mbajti shënim emrin. Me përtësë e ngriti dorën një i dytë. Ishte studenti i degës së skulpturës, Mithat Fagu. E shënoi dhe emrin e

tij. Asnjë nga të pranishmit nuk e ngriti më dorën. Ëndërronin të bëheshin ose piktorë, si profesor Buza, ose skulptorë si profesor Paskali.

Viktori, i kënaqur se gjeti dy emra të përshtatshëm, shkoi në Ministri dhe i dha ato.

Disa javë më vonë, Mithati, i penduar shkoi në Ministri dhe kërkoi t'ia hiqnin emrin.

- Po të ishte për Moskë, hajde de, po për Çekosllovakia as mos të shkojë në mendje. Bile, në Moskë doja të shkoja të studioja për regjisor, por jo për operator, u tha Mithati atyre dhe u largua.

Po kjo pikë e zezë, thanë ata në Ministri. E kemi një bursë dhe biri i botës refuzon. Ç'të bëjmë? I shkuan nëpër duar edhe një herë të katërqind e ca formularët e gjithë maturanëve të Shqipërisë dhe: EUREKA! E gjetën. Njëfarë Piro Milkani nga Korça paska kërkuar të studiojë për kinematografi. Më i vogli në moshë, nuk i ka mbushur akoma shtatëmbëdhjetë vjetët, po notat i paska të gjitha pesa. U bëftë më e mira! Le të shkojë Pirua në vend të Mithatit. Këtë mister e mësova në Pragë nga Saimi, që u bë shoku im më i mirë. Nip i Kallfeve, fotografët e njohur të Studios Kallfa në Tiranë, e kishin mësuar Saimin të fotografonte, por veçanërisht të retushonte fotografitë që klientët të dilnin më të bukur sesa ishin në jetë. Ai më mësoi abc-në e parë të fotografisë para profesorëve të miçekë. Pas maturës, Mithati shkoi të kryente shërbimin e detyruar ushtarak. Unë në Pragë ai në repart. Pasi u lirua më 1959, e dërguan në Moskë për të studiuar

regji filmi. Aty ku kishte dëshiruar. Mik të fortë duhet të kishte pasur. Veçse as miku e as Mithati vetë nuk mund ta parashikonin se në vitin 1961, mijëra studentë shqiptarë do të ktheheshin me pushime, por nuk do të riktheheshin më në Europë. Kish filluar një “miqësi e re”. Ajo me Kinën e Mao Ce Dunit.



*Në vitin e parë të Fakultetit të Filmit.
Pragë, 1956.*

SAUNA FINLANDEZE

Historikisht, Çekosllovakia, e shpallur si shtet i pavarur në vitin 1918, krijoi një reputacion të mirë në botë në fushën e sporteve. Atletika, hokeji, futbolla apo sportet dimërore në aktivitete ndërkombëtare e rendisnin atë në grupin e vendeve më të mira, edhe pse asnjëherë nuk e kaluan numrin e 15 milionë banorëve. Për rininë çekosllovake të Pasluftës së Dytë Botërore, çifti Dana dhe Emil Zatopek u kthyen në simbol frymëzimi. Zatopeku me katër rekordet e tij olimpikë dhe Dana rekordmene botërore në hedhjen e shtizës. Për kohëzgjatje kishin lindur në një ditë, më 23 nëntor të vitit 1922. Ata ishin çifti i atletëve që për nga popullariteti ua kalonin gjithë figurave politike, akademike apo artistike të kohës. Zatopeku, ky simbol i rinisë çekosllovake, u bë edhe më i dashur kur në vitin 1968 dënoi publikisht okupacionin rus dhe për pasojë u privua nga çdo funksion apo aktivitet sportiv dhe përfundoi si punëtor i thjeshtë në një ndërmarrje

për çmimin e puseve të ujit deri në vitin 1990, kur shpërtheu Revolucioni i Kadifenjtë. Pas disidentit, Vaclav Havel, ai vinte i dyti për popullaritet, renditje që e mbajti deri në ditën e vdekjes së tij, në vitin 2000.

Po pse ndodhte kështu? Sepse, si në Republikën e Parë, 1918-1938, ashtu dhe në të dytën, 1945-1990, lëvizja sportive ishte tepër masive. Kulmi i tyre ishin Lojërat e Sokolëve (në Republikën e Parë) dhe Spartakiadat Kombëtare (në të dytën), ku pjesëmarrësit e kalonin gjysmë milionin e njerëzve.

Mund të ishe student i arteve, mjekësisë apo shkencave ekzakte, por programet sportive, në ciklin e mesëm apo të lartë, ishin të plota dhe të njëjta. Volejbolli, noti, rrëshqitjet me ski në malet me dëborë në dimër ishin programe të çdo fakulteti.

Pasi kisha provuar të gjitha llojet e sporteve që mund të praktikoheshin në terrenet e qytetit në verën e vitit 1958, studentët e Akademisë së Arteve, së bashku me ata të Fakultetit të Bujqësisë, në kuadër të programit sportiv do të shkonin kësaj here në Tzhebonj, qytezë mesjetare në jug të Çekisë, ku ndodheshin edhe strukturat sportive, për përgatitjen e sportistëve më të mirë për gara ndërkombëtare.

Aty do të praktikonim ato disiplina sportive që nuk mund të bëheshin në Pragë. Badmintoni, bejsbolli, tenisi, kanotazhi, noti në liqen, ishin pjesë e programit 15-ditor. Kushte ideale. Vila në brendësi të pyllit a pak më tej një liqen.

Profesori i kulturës fizike, një mesoburrë trupngjeshur e simpatik, në orët e pushimit, na mësonte shumëçka, veç për sport nuk fliste.

Në mesin e stërvitjeve sportive na udhëzoi që në mëngjes të shkonim në pyll e të mblidhnim trungje të prera. Arsyeja?... Sot në mbrëmje do të provonim saunën e vërtetë finlandeze. Buzë liqenit qëndronte një barakë druri. Në brendësi, në mes të dhomës, blloqe të mëdha gurësh. Aty i vendosëm trungjet e prera dhe i ndezëm dorë pas dore. Nga pasditja, gurët ishin nxehur së tepërmi. Kur filloi të bjerë muzgu, profesori na ftoi të shkonim në barakë. Vetëm djemtë. I pari u zhvesh lakuriq profesori. Pas tij të gjithë ne. Na tregoi se mund të uleshim në shkallët e drunjta. Por kujdes! Sa më lart shkallëve, aq më i nxehtë do të ishte avulli. E zbrazim sipër gurëve bidonin e parë me ujë dhe për pak çaste çdo gjë avulloi. Pastaj të dytin e të tretin. Nga avulli mezi dallonim njëri-tjetrin. E përmes këtij avulli dëgjonim profesorin të na thoshte se sauna është sporti më popullor në Finlandë, por jo veç atje, por edhe në Suedi e Norvegji. E preferojnë këtë sport veçanërisht në dimër. Dhe, pasi trupi nxehej e nxehej e djersitej, në çdo “por” të tij dilnin nga baraka dhe shtriheshin në dëborë.

Pas gjysmë ore kullonim djersë. E në një moment të caktuar profesori na urdhëroi të dilnim prej andej dhe përmes një ure që lidhte barakën me liqenin të vraponim dhe të hidheshim zhytas në liqen. Veçse urë nuk ishte. Mbi shtylla druri të ngulura në tokën e butë

shtriheshin dy listela druri e anash tyre kallamishte të larta mbi tre metra. Vrapuam njësh kolonë e më pas plluc e plluc hidheshim në liqen. Kënaqësi e paparë.

Dhe çudia ndodhi. Duke u kthyer për te vilat e banimit, nuk ndienim asnjë peshë në trup. Ndiheshim të lehtë, si të ecnim në hënë. Pasi bëra dush me ujë të ngrohtë dhe vesha tutat blu, i gatshëm për të shkuar në mensë, dëgjoj Vashkun të më thotë se po më kërkon Shofri. Dola nga vila ime dhe shkova tek ajo përbri simes. I thërras, po në vilë s'kishte njeri. I thërras për së dyti, asgjë. Pas pak dëgjoj një zë që gati pëshpëriste: "Piroo!... Pirooo!".

Pëshpërima vinte nga tjetërkund. Nga kallamishtet e larta buzë liqenit. Afrohem andej nga vinte zëri dhe e gjej Shofrin të fshehur pas tyre.

Ç'po bën këtu?

Në saunë kanë shkuar vajzat. Pas pak do të dalin. Mbuloji duart me mëngët e tutave dhe eja pas meje poshtë urës.

A je në vete? Po është turp!

Çfarë turpi? Ne jemi kineastë. Ndoshta një ditë do të na duhet të realizojmë një skenë të tillë në film. Pse ta vrasim mendjen sesi ta bëjmë kur mund ta shohim në praktikë si ndodh.

Më bindi. Fundja dhe unë kineast do të bëhesha. Duke u zvarritur mbërritëm poshtë listelave, që ishin të baraslarguara nja pesë a dhjetë centimetra larg njëra-tjetrës. U shtrimë barkas me sytë drejt listelave. Nga baraka vinin çuçurimat e vajzave. Nuk vonoi

dhe dera u hap. Njëloj si ne, gjysmë ore më parë, në njësh kolonë vraponin kineastet dhe agronomet e ardhshme. Përmes të çarave dallonim të kalonin ato. Diçka e errët midis këmbëve të tyre dallohej turbull. E më pas u ngritëm gjithë kujdes për të parë siluetat e kokave të tyre në liqen dhe britmat e kënaqësisë që u jepte uji i liqenit.



Në aksionet vullnetare me shokët e fakultetit.

Çeki, 1958.

Kursi i tretë i degës së kamerës përbehej nga gjashtë studentë. Pesë çekë dhe unë. Jaromir Shofri ishte, pa dyshim, më kontroversi dhe më i dalluari ndër ne të gjashtë. Në çfarëdolloj detyre praktike mënyra e ndriçimit dhe kompozimit të kuadrit ishte gjithmonë ndryshe nga ajo e jona, tradicionalja.